



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**  
**Mbledhja nr. 137/2024**  
**Prishtinë, më 25.06.2024, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Munguan:** Mimoza Kusari-Lila dhe Abelard Tahiri, anëtarë.

**E ftuar:** Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë, Getoar Mjeku, Edita Pozhegu dhe Valon Prebeza, Ministria e Ekonomisë

**Pjesëmarrës tjerë:** Getoar Mjeku zv.ministër, Edita Pozhegu dhe Valon Prebeza, Ministria e Ekonomisë; Salih Hoxha, Elsa Krasniqi, Sami Gashi, Bedri Baliu – GP LVV, Festim Bytyçi – GP AAK, Lulzim Beqiri, ekspert, Arianit Behrami – Kuvend, Jeta Huruglica – GP LDK dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 4.6.2024;
3. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin për vitin 2022;
5. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me gjashtë (6) vota për.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 4.6.2024**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 4.6.2024, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit**

**Kryetari**, theksoi në përputhje me nenin 42 të Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, njoftoi se kryesuesit aktual të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU, i ka përfunduar mandati më 17 qershor 2024, andaj, duhet ta shpallim konkursin për këtë pozitë sipas ligjit.

Komisioni, nxori këtë:

### V E N D I M

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU;
2. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit, në bazë të Ligjit;
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## **4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin për vitin 2022;**

**Kryetari**, tha se në bazë të nenit 29, të Rregullores së Kuvendit, dhe në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, sot kemi në shqyrtim raportin vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2022. Në fillim po ia kaloj fjalën ministres për një prezantim të raportit dhe mandej hapim debat.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha se qëllimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionare e vetme në Ndërmarrjet Publike Qendrore (NPQ), është identifikimi i natyrës dhe burimit të rreziqeve, madhësisë së tyre dhe gjasave që ato të ndodhin, në mënyrë që të mund të menaxhohen në mënyrë efektive. Ky raport thekson fushat potenciale të tronditjes financiare me të cilin përballen shtatëmbëdhjetë (17) NPQ-të në Kosovë. Ai shërben për të alarmuar më herët për rreziqet e mundshme fiskale, në mënyrë që aksionari të mund të marrë masat korrigjuese adekuate për të zbutur këto rreziqe, së bashku me Bordet e Drejtorëve (BD) në NP. Për shkak të të dhënave të kufizuara, raporti nuk mund të mat plotësisht madhësinë e këtyre rreziqeve dhe probabilitetin që ato të ndodhin, por ai mund të shërbejë si një hap i parë i rëndësishëm për diskutimet që duhet të zhvillohen ndërmjet Bordeve të Drejtorëve në NP, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrive udhëheqëse të linjës. Ky raport i Performancës së Ndërmarrjeve Publike, përveç seksionit një (1) si pjesë hyrëse, është i ndarë edhe në dy (2) seksione tjera kryesore. Seksioni dy (2) paraqet një përmbledhje të Qeverisjes Korporative të NPQ-ve. Ndërsa Seksioni tre (3) paraqet analizën e përgjithshme të sektorit të NPQ-ve në Kosovë dhe ndahet pastaj në pesë (5) nënseksione (Tabela 1). Ndërsa Seksioni katër (4) ofron analizën për secilën prej shtatëmbëdhjetë (17) NPQ-ve, duke përdorur tri veçori të gjëra të mbikëqyrjes financiare, bazuar në pragje të ndryshme të pesëmbëdhjetë (15)

indikatorëve të përzgjedhur të performancës financiare. Një vlerësim përmbledhës i secilës NP përmban katër (4) seksione: Analiza e performancës financiare; Analiza e rrezikut financiar; Qarkullimet fiskale në dhe nga Qeveria; Rreziqet kryesore fiskale për t'u adresuar dhe veprimet e sugjeruara për menaxhmentin e lartë. Në seksionin katër (4) është dhënë një analizë më e thellë për gjashtë (6) NP-të, të cilat në përgjithësi janë më të mëdha, kanë detyrime të mëdha afatgjate, marrin mbështetje direkt ose indirekt nga Qeveria dhe tregojnë shenja të rrezikut financiar.

**Kryetari**, tha se ky raport nuk i plotëson kushtet, mungojnë të dhëna dhe shifra që do të duhej të pasqyroheshin në këtë raport është cekur edhe në analizë. Nuk keni cekur askund në raport shifrat e subvencionimit nga ana e Qeverisë për ndërmarrjet publike, a mund t'i kemi shifrat për secilën ndërmarrje veç e veç, se sa kanë marrë mjete nga shteti, po ashtu, në total shifrën e subvencionimit për të gjitha ndërmarrjet publike. Përveç subvencionimit, sa milion euro qeveria ka dhënë kredi për ndërmarrjet publike, duhet të pasqyrohen këto shifra që të dimë performancën e ndërmarrjeve publike, po ashtu, në këtë raport nuk trajtohet Trepça në tërësi, është hera e dytë që nuk pasqyrohet Trepça Veri, kjo është shkelje e ligjit.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha sa i përket njësisë së Trepçës në Leposaviq, vitet 2022, sikur edhe në vitet paraprake nuk ka pasur raportim të përbashkët dhe kjo është duke u përmirësuar, tani raportimi është duke u bërë në mënyre të unifikuar dhe është rritur bashkëpunimi në nivel teknik dhe tani po shkojmë drejtë raportimit të unifikuar, i cili nuk ka ndodh asnjëherë deri me tani. Në lidhje me subvencionet, duhet të bëhet dallimi i subvencionimit të ndërmarrjeve me subvencionimin p.sh. të blerjes së energjisë elektrike gjatë kohës së krizës me energji elektrike, sepse ky nuk është subvencionim për ndërmarrjen. Sa i përket subvencioneve, janë të paraqitura në faqen 11 të raportit.

**Kryetari**, nga këto që shihet, po e marrim rastin e Trepçës, 1 milion euro kanë shkuar për investime kapitale dhe 5 ose 6 milion euro të tjera për shpenzime operative dhe paga, nuk po shoh që keni subvencionuar projekte zhvillimore, por shpenzime për operativë dhe paga.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha se për vitin 2022, përkrahja për investime kapitale tek ndërmarrjet është 3.1 milion dhe kjo nuk i përfshin investimet të tjera që janë të përkrahura, qoftë përmes Ministrisë së Infrastrukturës apo Ministrisë së Financave. Nëse e krahasojmë me vitet paraprake, kjo përkrahje është dyfishuar nga kjo qeverisje.

**Armend Muja**, tha se sa i përket pasqyra financiare të ndërmarrjeve publike, të hyrat nga shitjet, del që qarkullimi shihet një kthim në vitet 2021 dhe 2022, kjo nuk ka të bëjë me subvencionim, këto janë të hyra nga shitjet që e kanë bërë këtë diferencë. Në vitin 2022, kemi 10 ndërmarrje me fitim kurse në vitin 2019 kemi pas vetëm 2 ndërmarrje që kanë operuar me fitim, definitivisht ka progres i cili duhet të raportohet. Sa i përket fitimit dhe humbjes së ndërmarrjeve neto, ka të dhëna të cilat janë paraqitur në raport dhe kemi të dhënat e ATK-se, ka një ndryshim mes tyre sepse të dhënat e ATK-së, fitimi i ndërmarrjeve nga të dhënat e ATK-së është më i madh se sa fitimi i ndërmarrjeve që janë paraqitur në raport, dhe nëse i shikojmë pasqyrat, shihet se rënia e ndërmarrjeve ka filluar nga viti 2014 dhe deri në vitin 2020, këto kanë qenë me humbje. Sa i përket numrit të punëtorëve tek ndërmarrjet publike, në raport ceket se janë diku 10269 punëtorë, që i bie rreth 1200 më i vogël se sa në vitin 2019-2020. Sipas të dhënave të ATK-së, në vitin 2019 kemi pasur 13963 punëtorë të ndërmarrjeve publike, në ndërkohë që në vitin 2022 ky

numër ka rënë në 11967 apo rreth 2000 punëtorë me pak, kërkoj një përshkrim të këtyre mospërputhjeve të vogla. Në bazë të dhënave tuaja, por edhe të ATK-së, shohim se kemi disa ndërmarrje që kanë shpenzime me mbi 50% për paga, njëra ndër to është edhe Trepça, me diku rreth 90 deri në 100%, Drini i Bardh me diku rreth 70%, Trainkos 73%, Posta e Kosovës 70%, këto ndërmarrje duhet të monitorohen saktë. Sa i përket Ibër-Lepencit, për 10 vite ka operuar me nga 4 milion euro humbje për çdo vit, kurse në dy vitet e fundit ka kaluar me fitim, cila është procedura, kur një ndërmarrje vit pas viti raporton humbje, kur është koha që t'i thuhet stop dhe të shkohet në ristrukturim. Sa i përket Telekomit, nga viti 2014 deri në vitin 2021 ka operuar me humbje, në vitin 2022 ka pasur pak humbje, për herë të parë në vitin 2023 del me 7 milion euro fitim, duhet të komunikohet me menaxheret e tjerë përmes një mekanizmi të konsultimit. Sa i përket proporcionalitetit të KRU-ve, alokimi i fuqisë punëtore do të duhej të bëhet në bazë të konsumatorëve, p.sh. KRU Gjakova e ka numrin me të madh të punëtoreve, ka pagat më të larta dhe ndërmarrja që 10 vjet punon me humbje, pse duhet të ndodh kjo, nuk do të duhej që të kenë paga të ndryshme mes KRU-ve, po ashtu, edhe punëtorët do të duhej të ishin në bazë të numrit të konsumatorëve, propozoj të kemi një platformë të përbashkët të përbashkët për të gjitha KRU-të, ku do të kishim të dhënat më të qasshme.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë,** tha sa i përket mospërputhjeve me të dhënat e ATK-së do të shohim këtë çështje, së bashku me njësinë për monitorim të ndërmarrjeve. Sa i përket numrit të punëtoreve po supozoj se mund të jetë mënyra e llogaritjeve, por sidoqoftë do të specifikohet në raport në të ardhme më mirë. Sa i përket dallimit në paga, qëllimi ynë i përgjithshëm ka qenë të kontrollojmë rritjen e pagave dhe aty ku ndodh kjo, të jetë në kuadër të një nivelizimi dhe jo të rritjes ekstreme. Dallimet në mes të KRU-ve, qofshin dallime në performancë apo edhe në numrin e punëtoreve dhe dallimet në paga, gjatë vitit 2023, kemi miratuar një listë të indikatorëve për matjen e performancës për të gjitha KRU-të. E kemi diskutuar edhe bashkimin e kompanive rajonale të ujësjellësve, qoftë në një kompani të vetëm apo në 2 ose 3 të tilla, këtu do të marrim parasysh edhe opinionet e ekspertëve të kësaj fushe. Sa i përket mekanizmit të konsultimit, në mënyre të kohëpaskohshme ndërmarrjet komunikojnë mes vete dhe pajtohem që një platforme e tillë do të ishte e nevojshme për të shkëmbyer përvojat e mira në mes të ndërmarrjeve.

**Jeta Statovci,** tha se baza ligjore e ndërmarrjeve publike është e njëjta, por natyra e punës së tyre është e ndryshme, p.sh. tek KRU-të kemi monopol natyror kurse Posta përballet me një konkurrencë shumë me të egër dhe ndoshta ndërmarrjet të cilat kane konkurrencë të tillë duhet të kenë lehtësira që të përballohet kjo konkurrencë. Shohim rezultate jashtëzakonisht pozitive tek ndërmarrjet, të cilat vitin e kanë mbyllë me fitim për dallim me vitet e mëhershme, ku shumica prej tyre kanë operuar me humbje. Telekomit sipas këtij raporti ka 30% ulje të shpenzimeve operative, mirëpo duhet të theksohet se nuk është vetëm pakoja dalëse, por këtu ka ndikuar edhe kthimi mbrapsht i pozitave të avancimit në mënyre jo meritore, po ashtu, çështja e qirave dhe marketingut, të gjitha këto kanë ndikuar që kjo ndërmarrje të jetë me eficientë dhe këto janë vendime të faktorit njeri. Kërkoj informacione rreth planeve të mëtutjeshme me KEK-un rreth energjisë së ripërtitshme dhe çështja e Ibër-Lepencit, e cila ka storien e vet të suksesit.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë,** tha sa i përket planeve të KEK-ut për energjinë e ripërtitshme, tanimë është nënshkruar marrëveshja për zbatimin e planit për energjinë e ripërtitshme me Bankën Zhvillimore Gjermane dhe është duke u përfunduar studimi ambiental

dhe social dhe pritet që deri në fund të këtij viti të publikohet tenderi për ndërtimin e parkut solar. Sa i përket prodhimit të energjisë me erë, jemi duke shqyrtuar mundësinë që ankandi i erës me partneritet publiko privat, aksionet publike t'ia kalojnë KEK-ut, mirëpo, kjo është në fazën e diskutimeve dhe nuk mund të them me shume rreth kësaj çështje. Sa i përket Ibër Lepencit, jemi duke filluar me studime të fizibilitetit, në njërën anë po shohim mundësinë e modernizimit të hidroelektranës aktuale dhe mbulimi i kanalit të Ibër-Lepencit, në të ardhmen po shohim mundësi që ky mbulim të behët me panele solare dhe kjo do të rrisë efektin e prodhimit të energjisë se ripertrishme si dhe po shohim mundësinë e shtimit të nëse mund të behet hidroelektrana revocabile, nëse mund të shtohet niveli me bartje të ujit me pompa, ky është projekt ambicioz dhe po presim realizimin e një studimi të detajuar, para se të investohet. Sa i përket proceseve gjyqësore, është rritur zelli për të fituar në rastet ku Telekomit ka qenë në procese gjyqësore, tani kemi një ndërmarrje me stabile dhe për dalim nga e kaluara, kur janë bllokuar pagat për shkak të vendimeve gjyqësore, tani kjo ndërmarrje operon me fitim dhe nuk rrezikohen pagat nga këto procese. Jemi duke u përgatitur për lansimit rrjetit 5G. Sa i përket avancimeve pa procedurë, kemi kthyer mbrapa vendimet e tilla arbitrare, këto vendime i kanë kushtuar rreth 300 mijë euro në muaj Telekomit dhe tani këto raste i kemi dërguar në organet hetuese.

**Pal Lekaj**, tha se ky raport ka shumë mangësi, mungon analitika e çdo ndërmarrje publike, sot kemi prit të shohim tjera rezultate, po nisem nga uji i pijes, ku rreth 40-45% qytetarët nuk furnizohen nga rrjetet e ujësjellësit. Kemi vetëm dy ndërmarrje me opinion të pakualifikuar që janë me notë kaluese dhe të gjitha ndërmarrjet tjera kane opinion ose të rezervuar ose të kualifikuar që i bie nota me e dobët e pasqyrave financiare. Cilat do të jenë hapat tuaj në lidhje me veprimet ndaj këtij fenomeni, vetëm dy ndërmarrje janë me notë kaluese dhe të gjitha të tjerat janë me notë të dobët ose jo kaluese, nuk kemi investime kapitale dhe ka menaxhim të dobët, kur do të merrni masa ndaj bordeve të cilët kane keqmenaxhuar me këto ndërmarrje. Keni vendos njerëz politik nëpër borde të ndërmarrjeve publike, rasti i fundit në KEK, siç u raportua në media ku bashkëshorti i deputetes së mazhorancës. Shihni vështirësitë e operimit të Telekomit, në Prishtinë dhe nuk funksionon rrjeti i Valës, kjo nuk mund të pasqyrohet si sukses por dështim total i menaxhimit. Ju mund të paraqisni sa të doni rezultate dhe shifra, opinionin e auditorit të jashtëm nxjerr vetëm dy ndërmarrje me bilanc pozitiv dhe ky është dështim në menaxhim të këtyre ndërmarrjeve. Është një raport i përgjithësuar dhe jo me baza krahasimore.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha në lidhje me konstatimet tuaja, pajtohem se menaxhimi i ndërmarrjeve nuk është më i miri në botë, por është shumë më mirë se sa kur keni qeverisur ju, raporti është zyrtar dhe si i tillë është i bazuar në të dhëna zyrtare. Sa i përket investimeve, kemi cekur në raport investime, uljen e shpenzimeve etj. Kemi përkrahur rrjetet e ujësjellësit në KRU Gjakova, ku është shtruar rrjeti i ri në fshatin Guri i Kuq dhe Fierzë dhe është ndërtuar degëzimi në Ratkoc dhe është investuar në përmirësim të rrjetit ekzistues në qytetin e Gjakovës dhe në Morinë. Ndërsa, në Hidromoravë është investuar në përmirësim të rrjetit ekzistues Kamenicë-Viti-Gjilan. Investimet në sektorin e ujerave dhe kanalizimit, e kemi rrit buxhetin nga 500 mijë sa ka qene historikisht në 5 milion e 500 mijë euro, këto investime janë 11 herë më shumë dhe i bie që janë investimet me të mëdha që kanë ndodh në këtë sektor. Sa i përket Telekomit, ndryshimet aty janë me të dukshme se kudo tjetër dhe sa i përket kësaj ndërmarrje lirisht mund të krenohemi me të arriturat e saj. Opinionet e auditorit të jashtëm në 17 ndërmarrje kemi opinionin të përmirësuar vetëm në vitin 2022.

**Pal Lekaj**, tha po e marrim shembull KEK-un, në vitin 2019, 2020, 2021, ka pasur opinion të pakualifikuar nga auditori i jashtëm që i bije opinion pozitiv kurse në vitin 2022 ka pasur opinion të kualifikuar dhe po i bie se nuk ka shkuar kah përmirësimi, por është keqësuar gjendja dhe është degraduar menaxhimi. Shumica janë me opinion të pamodifikuar, përveç dy prej tyre, të tjerat i ke me opinion të rezervuar apo opinion i rezervuar. Nuk ka ndryshime pozitive në pasqyrat financiare edhe pse po i subvenciononi.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha se 7 nga 17 ndërmarrjet kane pasur përmirësim të opinionit në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021. Ajo qe thoni ju nuk qëndron, auditimi i shumë ndërmarrjeve tani po auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për dallim që me herët janë audituar nga kompani private dhe për këtë fakt kanë nxjerrë auditim pozitiv. E theksoj KEKU-un, ku për 5 vite është audituar nga kompani private kurse në vitin 2022 me kërkesë të Qeverisë është audituar nga ZKA-ja, ky është përmirësim i cilësisë dhe autoritetit të auditimit.

**Pal Lekaj**, tha se Trepça në vitin 2022 është audituar nga auditor privat dhe ka bilanc negativ, pra nuk po del ajo që po thoni ju në lidhje me auditimin nga kompani private.

**Driton Hyseni**, tha se ky raport paraqet shumë të dhëna krahasimore dhe paraqet performancën e ndërmarrjeve publike, janë informacione shumë përmbajtjesore dhe do duhej që secili prej nesh të ndihet i kënaqur nga niveli i përmirësimit të ndërmarrjeve publike. Koleget opozitare po i referohen një dokumenti që është dashur ti adresohet grupit të monitorimit të ligjit e jo Komisionit. Kemi shumë vlerësime për punën e KEK-ut për vitin 2022, me një fitim prej 106 milionë euro fitim, krahasuar me vitin 2021 është një rritje prej 66 milionë euro apo 167%, duhet të theksohet ky fakt kur kemi një ndërmarrje që përformon kaq mirë. Si erdhi deri të ideja që të mos kemi dividend nga KEK-u, kur kemi një fitim kaq të lartë, sa ka qene bordi i KEK-ut bindës që të gjitha fitimet duhet të ndalen për investime kapitale. Në raport ceket borxhi i ndërmarrjeve publike, nga situata aktuale, si është gjendja me këto kredi, sa kanë mundur ndërmarrjet të bëjnë shlyerjen e këtyre kredive. Tek ndërmarrjet publike të cilave duhet t'i ndahen subvencione për shërbime publike, siç janë Posta e Kosovës apo Hekurudhat e Kosovës, kisha dashtë të dijë se çka po mungon nga raportimi i tyre me qëllim që kjo të realizohet, po ashtu, në lidhje me rastet gjyqësore të KEK-ut, kemi një padi të aprovuar nga Gjykata për 1317 punëtorë, cila do të jetë kostoja për KEK-un nëse parashihet pagesa për të gjithë këta punëtorë?

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha në lidhje me padinë që e ceket, nuk i kam shifrat e sakta, por po provojmë ta marrim gjatë këtij takimi, sa i përket shlyerjes së kredive, këto janë projekte relativisht të reja dhe ende nuk ka filluar kthimi i tyre. Në lidhje me mosmarrjen e dividendës për vitin 2022, kemi vendos të mos e marrim dividendën, në mënyre që KEK-u të ketë mjete për investime në njësinë A3, për të cilën përgatitjet teknike po vazhdojnë dhe kjo do të rriste sigurinë e furnizimit me energji për vitet në vijim. Sa i përket obligimit për shërbim publik, këtu e kemi një problem serioz me rastin e Postës së Kosovës, e cila përballet me një konkurrencë jolojale, obligimin e shërbimit publik të Posta e Kosovës, për një periudhe nuk ka pasur rregullore për mënyrën e llogaritjes së obligimit të shërbimit publik, ARKEP në vitin 2022 ka nxjerrë një rregullore të tillë, e cila vepron retroaktivisht. Posta ka pasur vështirësi që ta bëjë ndarjen e këtyre shërbimeve në mënyrën e duhur sepse ka pasur shpenzime të tjera shtesë, të cilat nuk kanë mundur të vërtetohen dhe këto mospërputhje kanë çuar në një situatë pasigurie dhe

është e padrejtë ndaj Postës së Kosovës, sepse në dy vitet e fundit Posta e Kosovës do të dilte me bilanc pozitiv, por për shkak të këtyre problemeve nuk kemi mundur të kryejmë këto pagesa.

**Driton Hyseni**, pyeti edhe për investime kapitale dhe subvencionet, ku për çdo investim apo subvencionim bëhet një marrëveshje me secilën prej këtyre ndërmarrjeve publike qendrore, ku është arsyeja, behet që të rrihet niveli i besimit apo për t'u siguruar që investimi të shkojë në atë që parashihet investimi.

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha se një mangësi në lidhje me këtë është se në vitet e kaluara, projektet nuk kane qenë të përgatitura me kohë, në anën tjetër marrëveshjet gjithashtu nga ana e ministrisë nuk kanë qenë të nënshkruara me kohë, dhe meqenëse duhet të kryhen investimet brenda një viti buxhetor kemi pasur raste kur mjetet në buxhet ndërmarrja nuk ka arritur ti kryej procedurat e prokurimit dhe këto mjete kanë mbetur të pashfrytëzuara. nga viti i kaluar jemi siguruar që ndërmarrjet t'i paraqesin projektet e tyre, këto prioritizohen me kohë dhe përgatiten me kohë dhe marrëveshjet janë nënshkruar me herët sipas asaj që kemi mundur dhe kjo do ta rrisë nivelin e investimeve. Për secilin investim që e përkrahë Ministria e Ekonomisë, aplikohet një marrëveshje e tillë dhe kërkohet raporti i auditimit.

**Valentina Bunjaku – Rexhepi**, tha nëse në Telekom keni investuar kaq shumë dhe ne nuk po na punon vala ku është përgjegjësia? Sa i përket investimet në impiantet e ujërave të zeza në Gjilan, ku është ky proces? Ju potencuat që keni investuar në rrjetin e ujësjellësit në Gjilan, nuk ka asnjë investim në qytet, qytetarët furnizohen nga pusët dhe nuk mund të furnizohen nga ujësjellësi.

**Artane Rizvanolli – Ministre e Ekonomisë**, tha se impianti i ujërave të zeza në Gjilan, pas përcaktimit të lokacionit ka pasur disa komplikime rreth shpronësimeve, Komuna e Parteshit nuk ka bashkëpunuar për një periudhë dhe tani këto probleme janë zgjidhur dhe pritët që në këtë vit të kryhet shpronësimi dhe presim lansimin e tenderit për ndërtim. Investimi në fabrikën në Veleknicë të Gjilanit është ne fazën e vlerësimit të tenderit dhe presim që të behet këtë vit. Kurse në lidhje me Telekomin e Kosovës, ka investime në antenat nëpër qytete, siç janë Gjilani dhe Ferizaj, qytetarët kanë pasur përmirësime, por jo në masën që duhet të jenë. Në ditët e fundit kemi investime përreth Prishtinës dhe të përfundojmë me qendër ku këto investime do të përfundojnë deri në fund të muajit korrik.

**Armend Muja**, pyeti rreth paraqitjes se strukturës gjinore në raport, dhe ne e kemi për detyrë që të kemi një bilanc gjinor në ndërmarrjet publike, a mund ta kemi një raport të strukturës gjinore ne ndërmarrjet publike, duke përfshirë edhe bordet. Po ashtu, duhet struktura e moshës se punëtoreve në ndërmarrje, p.sh. të KEK-u gjysma e punëtorëve të KEK-ut janë mbi 55 vite, duhet të kemi plan B, kjo ndodh edhe me ndërmarrjet tjera siç është Telekomit dhe të tjerat. Duhet të dimë se kah po shkojnë ndërmarrjet në 10 vitet e ardhme, sa i përket moshës se punëtoreve. A mund të kemi një aneks për Aeroportin e Prishtinës, KEDS-in, KESCO-n edhe pse janë privatizuar, duhet të kemi të dhëna për operimin e tyre. Unë kam marrë pasqyrën e bilanceve në 10 vitet e fundit për ndërmarrjet publike dhe shohim se fitimi i ndërmarrjeve publike në dy vitet e fundit janë rritur. Në lidhje me KEK-un, mua me shqetëson fakti se menaxheret të cilët e kane nxjerrë në fitim, madje në kulmin e fitimit të kësaj ndërmarrje ata arrestohen, në kushte normale menaxheri që e nxjerrë në fitim ndërmarrjen duhet të nderohet dhe jo të arrestohet, e njëjta ka ndodh edhe me Ibër Lepencin, kjo duhet të sqarohet.

Në lidhje me funksionimin e ndërmarrjeve publike në vendet tjera në Evropë, kryesisht në çdo muaj publikohen në ueb faqe, kohëzgjatja e raportimit, siç bëhet tek ne, e pamundëson ndërhyrjen për përmirësim. Do të ishte mirë që të dhënat për ndërmarrjet publike në formë të agreguar të publikohen çdo 3 muaj. Po ashtu, duhet të bëhet vlerësimi i aseteve të ndërmarrjeve publike, që të dimë saktë vlerën e aseteve.

**Kryetari**, tha duke e krahasuar me vitin 2023, sepse disa nga ndërmarrjet kanë nisur të publikojnë raportin e vitit 2023, dua të ndalem te KEK-u, nga mbi 105 milionë euro fitime në vitin 2022, nga raporti zyrtar del sa ka një rënie prej 13.5 milionë euro fitim në vitin 2023. Në mihjet e KEK-ut operohet pa licenca, kjo është vepër penale, ku pa qene të pajisur me licenca kanë vazhduar mihjet edhe në afërsi prej 250 metra afër objekteve, rezervat në deponitë e KEK-ut nuk janë më shumë se sa për dy jave prodhim, këtu ka një seri shkeljesh ligjore, për të cilat kërkoj të ndërmerrni hapa për këtë. Operimi pa licencë bëhet edhe në plantacionin e minierave në Stan Tërg, operimi pa licencë është shkelje e Ligjit të minierave dhe kjo është vepër penale. S'ka performancë pozitive as për Trepçën, as për KEK-un, as për Telekomin. Niveli i shërbimit të ujit dhe trajtimi i ujërave të zeza, nuk kemi asnjë përparim, për këto shqetësohem dhe ndërmarrjet të cilat po i prezantoni si të suksesshme, në fakt janë duke operuar, duke shkelur rregulloret dhe ligjet në fuqi. A keni informacion pse nuk keni rezerva në deponitë e KEK-ut më shumë se sa për një javë? Kush merr përgjegjësi kur shkelet ligji në eksploatim, eksploatohet pa licencë, siç është rasti në KEK, a merr përgjegjësi KEK-u apo shefi i ndërmarrjeve publike, çka keni vepruar për parandalim të shkeljes flagrante të ligjeve, cilat janë veprimet që i keni ndërmarrë?

**Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë**, tha se në vitin 2023 KEK-u ka qene për 6 muaj me një bllok në prodhim dhe kjo ka ndikuar në performancën e KEK-ut, sa i përket raportimeve të rregullta, raportet financiare publikohen nga Ministria e Financave, sa i përket një platforme të përbashkët, ku do të publikohen raportet në baza 3 mujore që e propozuat nuk e di sa është e realizueshme, por do ta shqyrtojmë si opsion. Lidhur me raportet e vitit 2023, mund të diskutojmë në një takim tjetër sepse sot këtu kemi këtu të diskutojmë për raportin e vitin 2022.

*Për shkak të mungesës së kuorumit, votimi i Raportit vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin për vitin 2022 shtyhet për mbledhjen e ardhshme.*

## **5. Të ndryshme**

**Valentina Bunjaku – Rexhepi**, kërkoi që për mbledhjen e radhës të diskutohet në rend dite, mundësia e monitorimit për nëpunësit publikë në Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës, duke kërkuar me shkrim nga KPMSHC për monitorim urgjent nga ana e tyre, ose Komisioni duke mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:45.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Ferat Shala,**

-----  
**Kryetar i Komisionit**